



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR

Nr. 1288 prot.

Elbasan, më 14.05.2026

VENDIM

Nr. 5, datë 14.05.2026

**"PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR KRYETAR TË  
KËSHILLIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT  
"ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si dhe në zbatim të nenit 15 dhe 16 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Këshillin Studentor të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor,

VENDOSI :

1. Të shpallë procesin e kandidimit për Kryetar të Këshillit Studentor të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Të drejtën për të kandiduar e kanë të gjithë studentët që ndjekin studimet me kohë të plotë në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
3. Afati për paraqitjen e kandidaturave fillon më datë 15.05.2026 dhe përfundon më datë 22.05.2026 ora 14:00.
4. Kandidatët e interesuar duhet të të dorëzojnë pranë zyrës së Protokoll Arkivës të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dokumentet e mëposhtme:
  - a) Kërkesën për kandidim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe një deklaratë të shprehjes së vullnetit për kandidim për Kryetar të Këshillit Studentor;
  - b) Një listë mbështetëse të nënshkruar nga 30 (tridhjetë) studentë;
  - c) Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
  - d) Vërtetim që provon se është student me kohë të plotë pranë fakultetit përkatës;
  - e) Letër motivim;
  - f) Curriculum Vitae;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR

KRYETAR

Elisa Heshi

Anëtar

Ronja Deka

Anëtar

Friola Pepa

Anëtar

Paula Tabares

Anëtar

Hymelt Lorga